



Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në IAL.

Viti Akademik 2020-2021

KREU IV/3		Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu IV/3, pika 1 Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat e përcaktuara, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-ja.	20.08.2020 – 30.08.2020
2.	Kreu IV/3, pika 6 IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datën e përcaktuar, publikojnë në mjedisë të dukshme dhe në faqen e tyre elektronike zyrtare listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	03.09.2020
3.	Kreu IV/3, pika 8 IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	12.09.2020
4.	Kreu IV/3, pika 9 Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.	19.09.2020
5.	Kreu IV/3, pika 10 Pas datës së përcaktuar, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët e renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.	19.09.2020
6.	Kreu IV/3, pika 11 IAL-të brenda datës së përcaktuar, përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.	07.10.2020
7.	Kreu IV/3, pika 13, shkronja “b” Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës së përcaktuar ia komunikon IAL-së.	24.01.2021
8.	Kreu IV/3, pika 13, shkronja “f” IAL-të brenda datës së përcaktuar, dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar në formë shkrësore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.	15.11.2020